

Raportimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje

JANAR – GUSHT 2022

Tetor 2022



Grupi për Studime
Juridike dhe
Politike



Raportimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje

JANAR – GUSHT 2022

Autor:

JUST REACT – Boosting Civic Reaction
towards an Improved Access to Justice
in Kosovo

Kontribuuan në shkrimin e raportit:

Liridon Salih, Senad Telaku, Urata
Gashi dhe Valentina Shahini-Grajqevci

Shtator 2022

Projekti "JUST REACT – Boosting Civic
Reaction towards an Improved Access
to Justice in Kosovo" financohet nga
Bashkimi Evropian dhe implementohet
nga Grupi për Studime Juridike dhe
Politike (GLPS) në bashkëpunim me
Fondin për Zhvillimin e Komunitetit
(CDF).



Përmbajtja

Hyrje.....	05
Vepra penale "Dhuna në familje" sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.....	06
Raportimi i rasteve të dhunës në familje në Policinë e Kosovës gjatë periudhës janar-gusht 2022.....	08
Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.....	11
Analizimi i 43 aktgjykimeve të publikuara për rastet e dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë (janar-gusht 2022).....	13
» Mosrespektimi i afatit për caktimin dhe mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.....	13
» Llojet e aktgjykimeve të analizuara.....	14
» Llojet e dënimeve të shqiptuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë.....	15
» Kohëzgjatja e gjykimit të rasteve të dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë.....	17
» Karakteristikat e viktimave dhe të akuzuarve të dhunës në familje sipas aktgjykimeve të analizuara.....	18
» Trajtimi i rasteve gjyqësore kur të akuzuarit për dhunë në familje ishin recidivist të veprave penale.....	19
» Roli dhe kompetencat e Qendrave për Punë Sociale në raport me viktimat e dhunës në familje.....	20
» Roli dhe kompetencat e Shërbimit Korrektues të Kosovës ndaj të dënuarit për dhunë në familje.....	21
» Mandati i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV).....	22
Përfundimet dhe rekomandimet.....	23

Shkurtesat:

GjTh – Gjykata Themelore

KPPRK – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

KPRK - Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Kushtetuta – Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ligji – Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje

PK – Policia e Kosovës

PTh – Prokuroria Themelore

QPS – Qendra për Punë Sociale

ShKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

Udhëzuesi i Supremes – Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

ZMNV – Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave

Hyrje

Dhuna në familje është një problem i përhapur social, që kalon kufijtë dhe ndodh në të gjitha kulturat dhe shoqëritë anembanë botës. Padyshim, as vendi ynë nuk përjashtohet nga prezenca e këtij fenomeni, nga i cili çdo ditë e më shumë po cenohet integriteti fizik, psikologjik, ekonomik, seksual dhe social i grupeve më të ndjeshme të shoqërisë: grave, fëmijëve dhe të moshuarve.

Dënimi i të njejtës dhe kryesve të saj është trajtuar në aspektin legjislativ në disa akte juridike përfshirë këtu Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje (Ligji), e më pas edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019, ku fenomeni i dhunës në familje përcaktohet si vepër e veçantë penale në kuadër të nenit 248 të këtij Kodi.

Për shkak të mentalitetit mbizotërues shoqëror në vend, dhuna në familje më shumë është trajtuar, dhe fatkeqësisht ende trajtohet në të shumtën e rasteve, si një çështje private dhe si një pjesë normale e jetës bashkëshortore e familjare. Mirëpo, kohëve të fundit vlen të theksohet se vetëdija shoqërore karshi dhunës në familje si vepër penale dhe dukuri e papranueshme është duke u rritur dhe e njëjta trajtohet si çështje inkriminuese jo vetëm nga institucionet shtetërore por edhe nga personat laik. Kosova si shtet gjindent në një fazë kyçe ku personat që kryejnë dhunë në familje duhet të sanksionohen sipas ligjit ndërsa viktimave duhet të synohet t'i sigurohet mbrojtje dhe siguri.

Përmes kësaj analize, projekti "Just React" synon të vë në pah të dhëna të rëndësishme lidhur me trajtimin institucional të rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës 1 janar – 31 gusht 2022, duke përfshirë këtu numrin e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës si dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore në Prishtinë.

Pjesë e analizës janë të dhënat zyrtare nga Policia, Prokuroria dhe Gjykata Themelore në Prishtinë. Këto të dhëna përfshijnë numrin e rasteve të raportuara, numrin e aktakuzave të ngritura, numrin e aktgjytimeve, përfshirë këtu edhe karakteristikat e kryerësve dhe viktimave të dhunës në familje, me theks të veçantë moshën dhe gjininë e tyre.

Po ashtu, në këtë analizë është analizuar edhe politika ndëshkimore bazuar në aktgjykimet për rastet e dhunës në familje gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022, nga Gjykata Themelore në Prishtinë të publikuara në ueb portalin e KGJK-së.

Në pjesën e fundit, analiza përfshinë në mënyrë të përgjithshme kompetencat dhe detyrat e institucioneve të tjera në raport me kryerësit dhe viktimat e dhunës në familje si dhe rekomandimet konkrete nga ana e projektit "Just React" që dalin nga analizimi i këtyre të dhënave të siguruara për këto raste në periudhën janar-gusht 2022.

Vepra penale “Dhuna në familje” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019, në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër martesës dhe familjes, e ka përcaktuar dhunën në familje si vepër të veçantë penale në kuadër të nenit 248, duke paraparë dënim me gjobë dhe me burgim deri në tri vite.¹

Sipas paragrafit 1 të këtij neni “Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet”². Sipas këtij përkufizimi rezulton se për tu konsideruar së është shkaktuar dhuna në familje kusht është që kjo vepër penale të kryhet brenda një marrëdhënie familjare të cilën KPRK-ja e përkufizon si marrëdhënie në mes të personave që janë të fejuar apo kanë qenë të fejuar ose janë të martuar ose kanë qenë të martuar ose që janë në bashkësi jashtëmartesore apo kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore ose bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose kanë bashkëjetuar në ekonomi të përbashkët; përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë; ose janë prindër të një fëmije të përbashkët.³

Ndërsa për dallim nga paragrafi 1 i nenit 248 të KPRK-së, në paragrafin 3, dhuna në familje përkufizohet si vepër penale e cila kryhet nga çdo anëtar i familjes i cili ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj dhe dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Nga kjo shohim se vepra penale e dhunës në familje sipas këtij paragrafi nënkupton kur ajo kryhet nga personat që përkufizohen si anëtar i familjes, ku bëjnë pjesë prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Prandaj, në rastin kur kemi të bëjmë me cilësimin e veprës penale, prokurori i shtetit duhet të ketë parasysh përkufizimet “marrëdhënie familjare” dhe “anëtar i familjes” ashtu që në bazë të raportit që ka kryerësi i veprës penale të dhunës në familje, të përcaktoj edhe nëse veprimet inkriminuese përshtaten me paragrafin 1 apo 3 të nenit 248.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 248, prill 2019, link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

2 Po aty, Neni 248, paragrafi 1

3 Po aty, Neni 113, paragrafi 25

Sa i përket llojeve të dhunës në familje, neni 248 i KPRK-së i njeh katër lloje, dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Mirëpo, ashtu siç është konstatuar edhe në Udhëzimin lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës⁴, pavarësisht se nën paragrafi 3.2 i këtij neni thekson se për nevojat e këtij Kodi përkufizimi i këtyre katër llojeve të dhunës do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje⁵, një përkufizim të tillë nuk e gjejmë në këtë ligj. Prandaj, edhe në këtë pikë sugjerohet që të bëhet ndryshim/plotësim i këtij ligji ashtu që të përfshihet përkufizim i detajuar për secilën nga llojet e dhunës në familje që i njeh KPRK-ja.

Për më tepër, në dispozitën e lartcekur të këtij ligji, dhuna në familje përkufizohet si një e vetme, jo e ndarë në lloje. Pra, sipas Ligjit, dhunë në familje paraqesin një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes, çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit dhe sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat.

Po ashtu, dhunë në familje nënkuptohet edhe ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë, përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përuljes se personit tjetër, marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual, kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër, dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë, vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike, hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër dhe rrëmbimi.⁶

Një gjë tejet të rëndësishme që e përmban neni 248 i KPRK-së është paragrafi 2, ku thuhet se "Kur çfarëdo veprë në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese". Pra, me rastin e gjyqimit të rasteve të dhunës në familje apo veprave të tjera që janë përcaktuar në këtë Kod, gjyqtarit i është rikujtuar edhe një herë se, ashtu si në nenin 70, par.2, nën par. 2.14, me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh si rrethanë rënduese nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare.

4 Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Qershor 2020, link: Udhëzimi 113/2020


5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje, Gusht 2010, Neni 2, nën paragrafi 1.2, link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>

6 Po aty

Raportimi i rasteve të dhunës në familje në Policinë e Kosovës gjatë periudhës janar-gusht 2022

Ashtu siç u tha edhe në hyrje të kësaj analize, "Just React" këtu do të përfshijë edhe të dhënat zyrtare të pranuar nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në kuadër të Policisë së Kosovës⁷, që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje të raportuara në tetë muajt e parë të këtij viti, të cilat janë paraqitur grafikisht në tabelat e mëposhtme.

Grafiku 1. Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës




Nga kjo tabelë shohim se në total, në Republikën e Kosovës, gjatë periudhës kohore janar-gusht 2022 janë raportuar në Policinë e Kosovës 1 mijë e 852 raste të dhunës, dhe referuar të dhënave zyrtare të pranuar nga ky institucion del se 581 raste apo rreth një e treta e total rasteve janë raportuar në rajonin e Prishtinës. Më pas, si rajoni më me së shumti raste të dhunës në familje të raportuara në këtë periudhë kohore është rajoni i Pejës me 239 raste, i pasuar me nga dy raste me pak nga rajoni i Prizrenit dhe ai i Mitrovicës (Jug dhe Veri). Ndërsa, nga këto të dhëna rezulton se nga rajonet që kanë më pak raste të raportuara të dhunës në familje në tetë muajin e parë të vitit 2022 janë Gjakova me 206 raste, Gjilani me 183 raste dhe i fundit rajoni i Ferizajt me 176 raste.

Tutje, GLPS nga të dhënat e pranuar prej Policisë së Kosovës, po ashtu një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe çështjes se nga totali i rasteve të raportuara në këtë institucion, sa persona janë të dyshuar për kryerjen e veprës penale "Dhuna në familje", sa persona janë arrestuar dhe sa është numri i viktimave nga kjo vepër penale.

⁷ Të dhënat zyrtare të pranuar nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në kuadër të Policisë së Kosovës, 21 shtator 2022

Grafiku 2. Statistika rreth numrit të personave të dyshuar, të arrestuar dhe viktimave të dhunës në familje në periudhën janar – gusht 2022




Nga tabela nr.2 shihet se nga numri total i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës, ekziston një mospërputhje mes numrit të personave të dyshuar dhe atyre të arrestuar, pra kemi 1 mijë e 725 persona të dyshuar se kanë kryer veprën penale të dhunës në familje gjatë kësaj kohe, ndërsa janë arrestuar vetëm 682 persona. Kjo nënkupton se jo në të gjitha rastet e raportuar është treguar efikasitet nga ana e Policisë në arrestimin e personave që dyshohet se kanë kryer dhunë në familje.

Prandaj GLPS bën thirrje që të rritet efikasiteti i Policisë në trajtimin e këtyre rasteve me profesionalizëm dhe efektivitet të lartë ashtu që në çdo rast të raportuar të zhvillojë hetime profesionale që do të rezultojnë me arrestimin e të dyshuarve ashtu që të njëjtit mos të jenë të lirë e me ç'rast të kenë mundësinë që prapë të përsërisin veprën e njëjtë ose të kryejnë vepër tjetër penale.

Po ashtu, nga këto të dhëna zyrtare shihet se edhe numri i viktimave në raport me numrin e total rasteve të raportuara është më i vogël, duke lënë të kuptohet se jo në të gjitha rastet e raportuara është arritur të konkretizohet se kush ka qenë viktimë e dhunës në familje, që në rastet më të shpeshta ndodh të jetë një anëtar i familjes por edhe disa prej tyre.

Sa i përket numrit të personave të dyshuar se kanë kryer veprën penale "Dhuna në familje" në periudhën janar-gusht 2022, GLPS ka siguruar informata edhe lidhur me çështjen se në cilën moshë bëjnë pjesë këta persona të dyshuar. Nga Policia bëhet e ditur se pjesa më e madhe e të dyshuarve i përketin moshës madhore, pra mbi 18 vite.


Grafiku 3. Personat e dyshuar sipas moshës



Siç shihet edhe në grafikonin e mësipërm, nga totali i personave të dyshuar se kanë kryer dhunë në familje gjatë tetë muajve të parë të këtij viti, vetëm 46 ose 3% prej tyre janë nën moshën 18 vjeçare, pra të mitur, ndërsa 1 mijë e 679 të tjerë janë persona madhorë, pra mbi moshën 18 vjeçare. Pra, nga kjo vijmë në përfundim se gjatë kësaj periudhe kohore numri më i madh i personave që dyshohet se kanë kryer dhunë në familje janë personat madhorë, me një përqindje shumë më të lartë sesa personat e mitur.


Ndërsa, ashtu siç edhe u cek më lartë se në total në nivel vendi gjatë kësaj periudhe tetë muajve janë raportuar në total 1 mijë e 859 raste, prej të cilave ka rezultuar me arrestimin e 682 personave të cilët dyshoheshin se me veprimet e tyre kanë kryer dhunë në familje. Por, nga këto të dhëna statistikore shihet se numri më i madh i të arrestuarve është i gjinisë mashkullore, pra 619 meshkuj apo rreth 91 % ndërsa më pak janë femrat ato që janë arrestuar si të dyshuara për këtë veprë penale, pra vetëm 63 apo rreth 9 %. Për më tepër shih grafikonin e mëposhtëm:

Grafiku 4. Personat e arrestuar sipas gjinisë



Tutje, në këtë analizë janë përfshirë edhe dy indikatorë të rëndësishëm sa i përket viktimave të dhunës në familje gjatë tetë muajve të parë të këtij viti. Bëhet fjalë për gjininë dhe moshën e viktimave të kësaj veprë penale, kur siç edhe do të paraqitet në mënyrë grafike, do të shihet se gjinia femërore është ajo që më së shpeshti është viktimë e dhunës në familje, ndërsa në bazë të indikatorit të moshës shihet se si viktima të kësaj veprë penale janë personat e moshës madhore.


Grafiku 5. Viktimat e dhunës në familje sipas gjinisë



Nga ana e Policisë së Kosovës kemi pranuar edhe informata zyrtare lidhur me moshën e personave që kanë qenë viktimë e dhunës në familje. Kësisoj, nga këto të dhëna del se personat nga moshë 20 deri në moshën 50 vjeçare përbëjnë numrin më të madh të viktimave të dhunës

në familje në periudhën janar-gusht 2022. Ndërsa si persona që më pak janë viktimë e dhunës në familje rezultojnë të jenë ata nga moshja 70 – 80 vjeçare dhe ata mbi moshën 80 vjeç.


Grafiku 6. Numri i viktimave sipas grup moshave



Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë

Duke qenë se të gjitha rastet e dhunës në familje bien në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore, në këtë analizë i kemi dhënë fokus Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, për të parë se sa raste janë pranuar gjatë periudhës janar-gusht 2022, dhe se si janë trajtuar këto raste nga ana e prokurorëve të angazhuar me këto lëndë. Kësisoj, në kërkesën drejtuar Zyrës për Informim dhe Monitorim të Mediave të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, më datë 27 shtator 2022, kemi pranuar informatat e paraqitura si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 7. Rastet e dhunës në familje të pranuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë




Nga të dhënat e paraqitura në grafikun rezulton se Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë tetë muajve të parë ka pranuar në punë 613 lëndë që kanë të bëjnë me veprën penale "Dhuna në familje". Prej tyre, 602 lëndë janë me kryes të moshës madhore ndërsa vetëm 11 kryes janë të moshës së mitur.

Pra, ashtu edhe siç u theksua edhe më lart, vijmë në përfundim se tek rastet e dhunës në familje, më së shpeshti në cilësinë e të dyshuarve kemi të bëjmë me persona madhorë e në më pak raste hasim kur kjo vepër penale kryhet nga persona të mitur.

Tutje, referuar të dhënave të pranuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës kohore janar-gusht 2022, lidhur me veprën penale "Dhuna në familje" del se kjo Prokurori ka ngritur 458 aktakuzë ndaj personave madhor, 15 raste me trajtim të detyrueshëm psikiatrik, dhe në 54 raste ka hudhur kallëzimet penale. Kurse lidhur me rastet kur kryesit e kësaj vepre penale janë të mitur, rezulton se kjo Prokurori në total ka zgjidhur 16 raste.

Grafiku 8. Trajtimi i rasteve aktive të dhunës në familje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës janar-gusht 2022



Siç shihet nga të dhënat e publikuara në këtë grafikon, Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-gusht 2022 ka trajtuar gjithsejtë 543 lëndë, ku në 458 prej tyre ka ngritur aktakuzë, në 54 raste ka hudhur kallëzimin penal, 15 raste kanë shkuar me trajtim të detyrueshëm psikiatrik ndaj të dyshuarve, kurse janë zgjidhur edhe 16 lëndë sa i përket kryesve të dhunës në familje që i përkasin moshës së mitur.

Nëse krahasojmë numrin e rasteve të pranuar dhe atyre të trajtuara nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, vërejmë se në këtë periudhë raportuese kjo prokurori ka arritur të trajtojë më pak lëndë të dhunës në familje sesa ato që i ka pranuar, pra kemi një diferencë prej 70 rasteve. Por, nëse marrim për bazë numrin e rasteve të dhunës në familje me kryes të mitur, shohim se kjo Prokurori ka treguar efikasitet duke zgjidhur numër më të madh të lëndëve sesa ato që i ka pranuar gjatë tetë muajve të parë të këtij viti.

Marrë parasysh nga ajo që u tha më lartë, rekomandojmë që Prokuroria Themelore në Prishtinë të rrit efikasitetin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje ashtu që të mos kemi një numër kaq të madh mes lëndëve të trajtuara dhe atyre të pranuar, duke bërë kështu që të kemi vonesa në trajtimin e këtyre rasteve. Në anën tjetër, GLPS e sheh tejet pozitive qasjen e Departamentit për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i cili në këtë periudhë raportuese ka arritur të tregojë efikasitet të lartë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje me kryes që janë të mitur, ashtu që nga 11 raste të pranuar ka arritur të zgjidh 16 raste, pra diku rreth 150% efikasitet.

Analizimi i 43 aktgjykimeve të publikuara për rastet e dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë (janar-gusht 2022)

GLPS në këtë analizë i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj, si njëra ndër gjykatat që ka më së shumti raste të tilla në nivel vendi. Për qëllime të kësaj analize, si burim informacioni është shfrytëzuar faqja zyrtare e KGJK-së përkatësisht e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku publikohen aktgjykimet në baza ditore, përfshirë këtu edhe për rastet e dhunës në familje që trajtohen nga kjo gjykatë.

"Just React" përmes këtij hulumtimi ka analizuar 43 aktgjykime⁸ për veprat penale të dhunës në familje, të publikuara në ëeb faqe të Gjykatës Themelore në Prishtinë në periudhën 1 janar – 31 gusht 2022.⁹ Gjatë analizimit të këtyre aktgjykimeve vëmendje e veçantë iu është kushtuar respektimit të afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, llojeve të aktgjykimeve të nxjerra nga kjo gjykatë, dënimeve të shqiptuara, karakteristikat e viktimave të krimit, gjendjes ekonomike dhe përgatitjes shkollore të kryerësve të këtyre veprave penale, llojit të dënimeve të shqiptuara nga gjykata, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si dhe kohëzgjatjes në marrjen e vendimit nga gjykata.

Mosrespektimi i afatit për caktimin dhe mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës në nenin 242, parasheh se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Kurse në rastet kur i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës.¹⁰ Pra, kjo dispozitë paraqet në mënyrë të qartë afatet brenda të cilëve gjyqtari i çështjes është i obliguar që të caktoj dhe të mbajë seancën e shqyrtimit fillestar brenda 30 dite nga momenti kur është ngritur aktakuza. Për më tepër, KPPRK-ja parasheh edhe afatin 15 ditor pas ngritjes së aktakuzës për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar, me kusht nëse ndaj të pandehurit është në fuqi masa e paraburgimit.

8 Aktgjykimet: P.nr.2018/21; P.nr.1372/2020; P.nr.171/2020; P.nr.336/20; P.nr.572/2020; P.nr.1888/20; P.nr.3042/2021; P.nr.3485/21; P.nr.3424/21; P.nr.7/22; P.nr.429/2022; P.nr. 416/22; P.nr.920/22; P.nr.895/22; P.nr. 913/22; P.nr.2372/21; P.nr.545/2021; P.nr.2018/21; P.nr.1372/2020; P.nr.336/20; P.nr.572/2020; P.nr.171/2020; P.nr.1888/20; P.nr.3042/2021; P.nr.3485/21; P.nr.3424/21; P.nr.7/22; P.nr.3675/21; P.nr.429/2022; P.nr.228/22; P.nr. 416/22; P.nr. 920/22; P.nr.895/22; P.nr. 913/22; P.nr.2372/21; P.nr.545/2021; P.nr.520/19; P.nr.2800/21; P.nr.2495/21; P.nr.3285/21; P.nr.228/22; P.nr.3675/21 dhe P.nr.459/20

9 Aktgjykimet e dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë, 1 janar – 31 gusht 2022, link: <https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/?r=M>

10 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Neni 242, paragrafi 4 dhe 5, janar 2013, link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

Por, gjatë analizimit të çështjes së respektimit të afateve procedurale nga ana e gjykatës në trajtimin e këtyre veprave penale, "Just React" ka gjetur se nga 43 rastet – aktgjykimet e analizuara që kanë të bëjnë me veprën penale "Dhuna në familje", në 30 prej tyre nuk është respektuar afati për caktimin e shqyrtimit fillestar, kurse vetëm në 13 raste shihet se është respektuar ky afat.

Grafiku 9. Afati për caktimin dhe mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar në aktgjykimet e analizuara



Siç shihet edhe nga grafiku nr.9, Gjykata Themelore në Prishtinë në 43 rastet gjyqësore të analizuara rezulton se në shumicën e këtyre lëndëve të dhunës në familje nuk e ka respektuar afatin ligjor prej 30 ditësh për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar në këto raste. Pra në 30 nga këto lëndë nuk është respektuar ky afat, ndërsa në vetëm 13 prej tyre seanca e shqyrtimit fillestar është caktuar dhe mbajtur brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e KPPRK-së.

Ndërsa, sipas këtyre aktgjyqimeve të analizuara, "Just React" ka gjetur se në një nga rastet e dhunës në familje gjykatës i janë dashur 952 ditë apo 2 vite, 7 muaj e 9 ditë për të caktuar seancën e shqyrtimit fillestar nga dita kur është ngritur aktakuza¹¹. Kurse, është gjetur se po e njëjta gjykatë në katër raste gjyqësore të dhunës në familje i është dashur vetëm një ditë nga ngritja e aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar¹². Nga kjo mund të kuptojmë që Gjykata Themelore në Prishtinë mund dhe duhet që të rris efikasitetin në trajtimin e këtyre lëndëve, me theks të veçantë sa i përket caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimit fillestar brenda afatit të përcaktuar si në nenin 242 të KPPRK-së.

Llojet e aktgjyqimeve të analizuara

Nga 43 aktgjykimet që janë analizuar nga "Just React" shihet se Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-gusht 2022, ka marrë tre lloje të aktgjyqimeve që parashihen me dispozitat e KPPRK-së. Pra, gjatë kësaj kohe kjo gjykatë ka shpallur aktgjyqime dënuese, liruese dhe aktgjyqime refuzuese. Por edhe nga ajo që shihet në grafikun e mëposhtëm vërejmë se pjesa më e madhe e aktgjyqimeve, pra në 35 lëndë apo 81% e tyre janë me aktgjykim dënues, 6 lëndë apo 14% janë me aktgjykim lirues ndërsa vetëm në 2 raste apo 5% të rasteve të analizuara e shohim se kjo gjykatë ka vendosur me aktgjykim refuzues.

11 Aktgjykimi në rastin P.nr.520/19,


link: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_LI_P_520_19_SQ.pdf

12 Aktgjykimet në rastet P.nr. 416/22; P.nr. 913/22; P.nr. 416/22 dhe P.nr. 913/22

Grafiku 10. Llojet e aktgjykimeve për rastet e dhunës në familje (janar-gusht 2022)

Llojet e dënimeve të shqiptuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë

Siç u tha më lartë, nga 43 rastet e analizuar në 35 prej tyre Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur që të shqiptoi dënime ndaj kryesve të veprës penale "Dhuna në familje". Por, nëse e shohim si statistikë i bie që në 81% të këtyre rasteve gjykata ka dënuar kryesit e dhunës në familje por shqetësues mbetet fakti që shumica e tyre janë dënime me kusht. Më poshtë, në formë grafike janë paraqitur llojet e dënimeve që ka shqiptuar Gjykata Themelore në Prishtinë në 35 aktgjykimet dënuese të publikuara në periudhën 1 janar - 31 gusht 2022:

Grafiku 11. Llojet e dënimeve të shqiptuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë ndaj kryesve të dhunës në familje

Pra, siç edhe shihet në grafikun e paraqitur, "Just React" ka gjetur se kjo gjykatë ka shqiptuar 20 dënime me kusht, pesë dënime me burgim efektiv, pesë dënime me gjobë dhe në pesë raste ka shqiptuar dënime të tjera. Kurse nga analizimi i pesë aktgjykimeve dënuese me burgim kemi gjetur se dënimi më i rëndë ka qenë dënimi me burgim efektiv prej 6 muajsh ndaj të dënuarit që paraprakisht i kishte të plotfuqishme edhe 12 aktgjykime të tjera për vepra të ndryshme penale¹³.

13 Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi me numër P.nr.2800/21, i datës 28.12.2021

Kurse, duke qenë se dispozitat e KPRK-së parashohin se kushdo që kryen veprën penale të dhunës në familje dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet¹⁴, vlerësojmë se një situatë e tillë që na paraqitet nga aktgjykimet e analizuara konsiston me një politike ndëshkimore jo adekuate të kryesve të dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Pra, një numër kaq i madh i rasteve ku kryesit dënohen vetëm me dënim me kusht e jo me dënime efektive mund të rrit mundësinë që ata të mund të kryejnë prapë këtë ose tjetër veprë penale dhe kështu vihet në pikëpyetje obligimi i institucioneve shtetërore në ruajtjen dhe mbrojtjen e institutit të familjes, si celulë bazë e shoqërisë.

Një çështje tjetër e analizuar në aktgjykimet dënuese për veprën penale të dhunës në familje të publikuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në periudhën janar-gusht 2022, janë rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kjo gjykatë i ka marr parasysh me rastin e shqiptimit të këtyre dënimeve.

Kështu, "Just React" ka gjetur se si rrethana lehtësuese me të shpeshta të cilat janë përmendur në pothuajse ç'do aktgjykim të dhunës në familje kanë qenë pendimi i të akuzuari, pranimi i fajësisë, keqardhja, gjendjen ekonomike, papunësia, i pa dënuar më parë dhe vazhdimin e bashkëjetesës.

Kurse sipas këtyre aktgjykimeve lidhur me rrethanat rënduese është gjetur se kjo gjykatë në 18 raste nuk ka gjetur rrethana rënduese ndaj kryerësit për kundër faktit se ka marr aktgjykim dënues. Ndërsa në dy aktgjykime kjo gjykatë në rrethanat rënduese ka përmendur faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar më parë, ndërsa nuk ka i përmendur vendimet me të cilat është dënuar më parë.

Kurse paragrafi 4 i neni 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës përcakton se "kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur".¹⁵ E që kjo nënkupton se recidivistit si rrethanë rënduese mundet ti merret vetëm atëherë kur i njëjti ka kryer vepra penale të të njëjtës natyre ose për të njëjti motiv, kurse nga këto aktgjykime shihet se gjykata si ka marr si rrethanë rënduese edhe pse kryerësi ka kryer vepra të natyre të ndryshme penale.

Po ashtu sipas këtyre aktgjykimeve, GLPS ka gjetur se në rastin me numër të lëndës P.nr. 416/22 kjo gjykatë si rrethanë rënduese ka marr parasysh faktin "se natyra e tillë e veprave penale është mjaft e shpeshtë në Republikën e Kosovës dhe ndikojnë në prishjen e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore në përgjithësi".¹⁶

E nga kjo evidentohet një qasje jo profesionale e gjykatës në mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pandehurit, kjo për faktin se në anën tjetër neni 69, i Kodit Penal nr.06/L-074 ka paraparë se kur gjykata të cakton dënimin për veprë penale, duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprë penale. Gjykata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. Si dhe parasheh që dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

Po ashtu ka paraparë që me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat që kanë të bëjnë me: shkallën e përgjegjësisë penale; motivet për kryerjen e veprës; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; rrethanat

14 Neni 248, Kodi Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës

15 Neni 69, Kodi Penal nr. 06/L-074. i Republikës së Kosovës

16 Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi me numër P.nr. 416/22, i datës 25.02.2022.

në të cilat është kryer vepra; sjelljen e mëparshme të kryerësit; pranimin e fajit dhe rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.¹⁷

GLPS vlerëson se sistemi i drejtësisë duhet të bëjë më shumë në arritjen e qëllimit të dënimit, risocializimit dhe rehabilitimit të kryerësve të veprave penale, kjo pasi në nenin 38 të KPRK-së përcaktohet se “qëllimet e dënimit janë: të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë, rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit”.¹⁸

Kohëzgjatja e gjyimit të rasteve të dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe aktet e tjera të aplikueshme në vendin tonë obligojnë që rastet gjyqësore të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Por duke qenë se fokus i kësaj analize janë rastet e dhunës në familje në bazë të 43 aktgjykimeve të publikuara në periudhën janar – gusht 2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, shohim se kësaj gjykate në disa raste i është dashur rreth 3 vite për ta gjykuar një lëndë të kësaj natyre, ndërsa në anën tjetër shohim se ka arritur që të nxjerrë aktgjykime për disa lëndë të dhunës në familje vetëm një ditë pas ngritjes së aktakuzës.

Pra, shohim se ka pasur raste kur kësaj gjykate nga ngritja e aktakuzës e deri në marrjen e vendimit për rastet e dhunës në familje iu janë dashur plotë 2 vjet e 7 muaj e 15 ditë, apo 958 ditë, ndërsa në një rast kësaj gjykate iu janë dashur vetëm një ditë për ta gjykuar. Ndërsa mesatarja e gjyimit të këtyre rasteve është rreth tetë muaj.

Kjo zvarritje në gjykimin e disa rasteve është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Tutje përcaktohet se, çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.¹⁹

Po ashtu kjo zvarritje bie në kundërshtim edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku përcaktohet se, “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.²⁰

“Just React” vlerëson se rastet e dhunës në familje nga Gjykata Themelore në Prishtinë nuk po trajtohen brenda një afati të arsyeshëm, prandaj marrë parasysh natyrën e këtyre lëndëve sugjeron që të njëjtat të jenë me prioritet të lart për secilin nga gjyqtarët që janë të ngarkuar me lëndë të kësaj natyre.

17 Neni 69, Kodi Penal nr. 06/L-074. i Republikës së Kosovës.

18 Neni 38, Kodi Penal nr. 06/L-074. i Republikës së Kosovës

19 Neni 31, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

20 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6, link: https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

Karakteristikat e viktimave dhe të akuzuarve të dhunës në familje sipas aktgjykimeve të analizuara

"Just React" gjatë analizimit të 43 aktgjykimeve të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Themelore në Prishtinë për periudhën 1 janar – 31 gusht 2022, ka pasur në fokus edhe çështjen e karakteristikave të viktimave të dhunës në familje sa i përket gjinisë së tyre, me qëllim që të kemi një pasqyrë me të detajuar se cila nga gjinitë është me e atakuar nga fenomeni i dhunës në familje.


Grafiku 12. Viktimat e dhunës në familje sipas gjinisë



Siç shihet edhe nga grafikoni, "Just React" ka gjetur se nga analizimi i 43 rasteve të dhunës në familje për të cilat janë publikuar aktgjykimet në tetë muajt e parë të këtij viti, në 35 raste apo 81 % e viktimave të krimit të dhunës në familje janë femra, ndërsa në 8 raste përkatësisht në 19% të tyre si viktimë paraqiten personat e gjinisë mashkullore. Nëse e marrim për bazë një përqindje të tillë rezulton se në katër nga pesë rastet e dhunës në familje viktimat janë femra ndërsa në një prej pesë rasteve viktimat është i gjinisë mashkullore.

Tutje, pjesë e kësaj analize janë edhe karakteristikat e kryesve të veprave penale të dhunës në familje sa i përket përgatitjes shkollore dhe gjendjes ekonomike të tyre. Lidhur me këto dy komponentë, "Just React" gjeti të dhënat e paraqitura në këtë grafikoni:

Grafiku 13. Përgatitja shkollore e të akuzuarve për dhunë në familje



Pra, nga të dhënat e analizuara e të paraqitura grafikisht shihet qartë se sa i përket përgatitjes shkollore të të akuzuarve për dhunë në familje pjesa më e madhe e tyre kanë të kryer shkollim të mesëm apo në 25 raste të akuzuarit kanë pasur të kryer shkollimin e mesëm, në shtatë raste

kanë pasur të kryer shkollimin fillore, tetë me shkollim të lartë, në dy raste të akuzuarit nuk kanë pasur fare shkollim, kurse në një rast nuk ka pasur të dhëna.

Tutje, sa i përket komponentës së gjendjes ekonomike të të akuzuarve për dhunë në familje, nga 43 aktgjykimet e analizuar rezultojnë se pjesa më e madhe e tyre apo 23 prej tyre janë të gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa 19 të tjerë janë të gjendjes së mesme dhe një i gjendjes së mirë ekonomike.

Grafiku 14. Gjendja ekonomike e të akuzuarve për dhunë në familje



Pra nga këto të dhëna del se mbi gjysma e të akuzuarve për dhunë në familje nga rastet e analizuar dalin se i përkasin gjendjes së dobët ekonomike apo 25 prej tyre, ndërsa 19 nga ta ose 44% të tyre kanë pasur gjendje të mesme ekonomike, ndërsa në një rast i akuzuari i kësaj veprë penale ka pasur gjendje të mirë ekonomike.

Trajtimi i rasteve gjyqësore kur të akuzuarit për dhunë në familje ishin recidivist të veprave penale

Nga vendimet e publikuara të Gjykatës Themelore të Prishtinës së bashku me degët e saj si Podujevë, Glllogoc, Graçanicë e Lipjan, për periudhën Janar-Gusht 2022, "Just React" ka gjetur se në tre raste të akuzuarit për dhunë në familje kanë qenë recidivist të dhunës në familje, ku në vetëm në njërin rast kryesi i dhunës është dënuar me burgim²¹, në një rast me dënim me kusht dhe gjobë dhe në rastin e fundit të gjetur është shqiptuar vetëm dënim me kusht.

Nga kjo vijmë në përfundim që në këto raste, dënimet e shqiptuara nga gjykata nuk kanë qenë adekuate ndaj kryesve të dhunës në familje, ashtu që nuk është arritur njëri ndër qëllimet kryesore të dënimit që ka të bëjë me parandalimin që në të ardhmen i dënuari të mos kryej veprë tjetër ose të njëjtë penale.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës përcaktohet se kur caktohet dënimi për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur.²²

21 Aktgjykimi P.nr.429/22

22 Neni 69, par. 4 i Kodit nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i kryesor i dënimit në procedurën penale është parandalimi i kryerjes së veprave penale dhe ndërgjegjësimi i përgjithshëm i qytetarëve lidhur me pasojat e dëmshme të tyre. Më saktësisht sipas këtij Kodi, qëllimi i dënimit është: Të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; Të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; Të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.²³

Prandaj, në të ardhmen sugjerohet që gjyqtarët që gjykojnë raste të tilla t'i kushtojnë rëndësi matjes së dënimit ndaj personave që vërtetohet se kanë kryer dhunë në familje, ashtu që lloji dhe lartësia e dënimit për kryerësin e veprës penale t'i përgjigjet peshës së veprës së kryer dhe rrezikshmërisë shoqërore të saj.

Roli dhe kompetencat e Qendrave për Punë Sociale në raport me viktimat e dhunës në familje

Në Republikën e Kosovës aktualisht janë 40 Qendra për Punë Sociale (QPS), një në secilën prej 38 komunave plus dy degë shtesë në Prishtinë. Qeveria lokale është burimi i vetëm i financimit për QPS-të. Sipas Rregulloreve Komunale për ndarjen e subvencioneve, kryetarët e komunave kanë të drejtë të ndajnë subvencione për individët dhe familjet, si dhe të mbështesin aktivitetet e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale.²⁴

QPS është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në ri-integrim të viktimës. Gjithashtu koordinon aktivitetet me akterët tjerë në procesin e mbështetjes së viktimës dhe fuqizimit të saj/tij.

QPS ndihmon viktimat e dhunës në familje kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, rehabilitim dhe integrim të viktimave në shoqëri. Çdo viktimitë referuar i caktohet një menaxher i rastit, i cili është zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese.

Qendra për Punë Sociale secilit rast të dhunës në familje i cakton një zyrtar për menaxhimin e rastit dhe mbështetjen e saj/tij në shërbime. Ky menaxher i rastit e merr përsipër mbikqyrjen e rastit. Menaxheri i rastit e vlerëson gjendjen sociale dhe ekonomike të viktimave të dhunës në familje. Kjo e mundëson QPS-në të identifikojnë nevojat e viktimës dhe t'i koordinojë shërbimet e duhura. Vizita në shtëpi mund bëhen me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të familjes, strehimore etj. Në përgjithësi, menaxheri i rastit e përkrah viktimën dhe e fuqizon që ajo të marrë vendimet në mënyrë të pavarur dhe përgjegjësi për jetën e saj /tij.

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare duhet të bëhen pas vlerësimit të nevojave. Viktima duhet të informohet lidhur me kushtet dhe obligimet që nevojiten për të përfituar shërbime. Menaxheri i rastit plotëson formën bazike të të dhënave për viktimën dhe koordinon aktivitetet me akterët tjerë për të ndihmuar dhe integruar viktimën. Menaxheri i rastit siguron që akterët tjerë e informojnë QPS-në lidhur me referimet në shërbime sociale të rastit. Gjatë ofrimit

23 Neni 38 par.1, nënpar.1.1 e deri 1.4 të Kodit nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës.

24 Rregullorja për Subvencionimin e Komunave, nr. 11/2013, në dispozicion në:
<https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/Municipality/Assembly/Regulations/Regullore-Komunale-2013/Rregullorja-Nr--11-2013-per-ndarjen-e-subvencioneve.pdf.aspx>

të shërbimeve, menaxheri i rastit është i obliguar të respektojë procedurat dhe afatet sipas legjislacionit në fuqi.²⁵

Zyrtar i Shërbimeve Sociale do të thotë profesionist i kualifikuar i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, në fushat e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, juridikut, pedagogjisë ose disiplinave tjera, të lidhura ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, licencuar dhe regjistruar në regjistrin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.²⁶

Sipas Udhëzimit Administrativ²⁷, personi fizik i cili ofron shërbime të trajtimit psikosocial për kryerësin e dhunës, duhet t'i plotësojë këto kushte dhe kritere: Të jetë i aftë për punë; Te jetë psikiatër, psikolog, sociolog, pedagog, punëtor social dhe të ketë licencë profesionale.

Ndërsa sa i përket këtij pikave që u cekën nga udhëzimi administrativ, sipas një hulumtimi të bërë është vërejtur se nga 164 zyrtarë që punojnë në Qendrat për Punë Sociale në tërë Kosovën, vetëm 6 nga ta kanë shkollim universitar në degën e punëve sociale. Të tjerët sipas hulumtimit janë të diplomuar në juridik, histori, ekologji, shkenca politike dhe fakultete të tjera. Po ashtu, përveç mungesës së shkollimit, pjesa më e madhe e zyrtarëve të QPS-së nuk kanë asnjë trajnim, i cili do të iu mundësonte të merreshin me procesin e risocializimit dhe ri-integrimit.²⁸

Roli dhe kompetencat e Shërbimit Korrektues të Kosovës ndaj të dënuarit për dhunë në familje

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) është krijuar me qëllim të ekzekutimit të sanksioneve penale si dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim për të mitur, masën edukuese korrektuese për të mitur si dhe masën e paraburgimit, dhe përbëhet nga këto Institucione Korrektuese: Qendrat Korrektuese, Qendrat e Paraburgimit dhe Institucionet e Sigurisë së Lartë. Në kuadër të një Institucioni Korrektues mund të ekzistojnë njësi të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur, varësisht nga nevojat e institucionit.²⁹

Shërbimi Korrektues pas pranimit në qendrën korrektuese të të burgosurve në fillim bënë vlerësimin individual të rrezikut duke marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar, moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore, veçoritë dhe nevojat e tjera karakteristike për të gjithë të dënuarit përmes Njësisë për Vlerësim dhe Klasifikim dhe pas procesit të vlerësimit hartohet plani individual për ekzekutimin e dënimit sipas specifikave të secilit të dënuar.³⁰

Me rastin e vendosjes së personit të dënuar, po ashtu duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkëta risocializuese, si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.³¹ Ndër përgjegjësitë kryesore të SHKK-së është edhe zhvillimi dhe implementimi i programeve për edukim dhe aftësim profesional si dhe programeve tjera për risocializimin dhe riedukimin e të burgosurve.³²

25 <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>

26 Neni 1 (1.3(i)), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

27 Udhëzimi administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje, tetor 2010, neni 5, par. 5.

28 <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/hulumtim-ne-kosove-historianet-i-trajtojne-ne-qendrat-sociale-familjet-qe-kane-probleme/>

29 Neni 21, par. 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 i Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

30 Neni 17, paragrafi 1 dhe 4 i Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

31 Neni 13, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-149 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

32 Neni 24, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 i Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Qëllimi i rehabilitimit është që ta nxisë procesin e ripërfshirjes shoqërore të të dënuarit që kërkon një shkëputje nga qëndrimet dhe sjelljet e tyre të mëparshme. Rehabilitimi shërben si një mjet i vlefshëm për ta ndryshuar rrethin e dhunës për ata që nuk shohin ndonjë mundësi tjetër për ta bërë këtë pa ndihmën e jashtme.

Ideja themelore prapa rehabilitimit nëpërmjet burgimit është se një person një herë i burgosur kurrë nuk do të dojë të kthehet në burg, pasi të jetë liruar. Në anën tjetër, shumë hulumtime argumentojnë se disa të burgosur do të mësojnë mënyra të reja dhe më të mira për të kryer krime, derisa janë të burgosur.³³ Prandaj, burgjet nuk janë mjet i garantuar për rehabilitim. Shërbime më të mira rehabilituese duhet t'u ofrohen të burgosurve, siç janë aktivitetet brenda dhe jashtë burgjeve.

Megjithatë, janë disa sfida që mund të bëjnë procesin e rehabilitimit të vështirë si pasojë e mungesës së mjaftueshme të buxhetit dhe pasi çdo gjë është e lidhur me burgjet, ka mungesë të stafit profesional (ekspertëve brenda burgjeve).³⁴

Ligji mbi Ekzekutimin e Sankcioneve Penale parasheh programin individual për korrektim dhe risocializim për të dënuarit që përfshin vendosjen në institucionin, ose në sektorin brenda institucionit; pjesëmarrjen në aktivitete arsimore; pjesëmarrjen në aktivitete të aftësisë profesionale; pjesëmarrjen në aktivitete kulturore, edukuese dhe sportive; punën dhe përmirësimin e aftësive profesionale; lidhjet familjare dhe kontaktet me botën e jashtme; kushtet për fitimin e të drejtës për pushim në shtëpi, për lirim me kusht, ose lirim të parakohshëm, dhe masat që synojnë përgatitjen për lirimin përfundimtar.³⁵

Bazuar nga këto që u cekën më lartë, vërehet se në Qendrat Korrektuese nuk parashihen programe të veçanta për riedukimin dhe risocializimin e kryesve të dhunës, gjë që nga monitorimi i rasteve të dhunës në familje në sistemin gjyqësor ka raste kur personat që kryejnë dhunë në familje gjatë qëndrimit të tyre në paraburgim, ata qëndrojnë në të njëjtën dhomë me persona që kanë kryer edhe vepra të tjera penale, dhe se ky fenomen është shqetësues, sepse kryesit e dhunës gjatë vuajtjes së dënimit nuk i nënshtrohen ndonjë programi të veçantë për riedukimin dhe risocializimin e tyre. Madje, as në rregulloren e brendshme të Shërbimit Korrektues për tretmanin e të dënuarve nuk parashihen programe të veçanta për kryesit e dhunës në familje.³⁶

Mandati i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV)

ZMNV funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili ka përgjegjësi primare për të siguruar drejtësi në çështjet penale. ZMNV ka për obligim të sigurojë mbrojtje të të drejtave të viktimave në sistemin e drejtësisë. Ky obligim ekziston gjatë procedurës se hetimeve, ndjekjes dhe dënimit të një kryesi, por edhe rastet kur shteti përmes Gjykatës mund t'i kufizojë të drejtat dhe privilegjet e kryesit si rezultat i një urdhri.

Mbrojtësi i Viktimave është përfaqësues i autorizuar i cili ka kompetencë për ta njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e tij/saj dhe përfaqëson viktimën në procedura në prokurori e gjykatë dhe kur është e nevojshme e referon viktimën tek ofruesit tjerë të shërbimeve. Mbrojtësi

33 <http://www.crimemuseum.org/crime-library/rehabilitative-effects-of-imprisonment/>

34 https://qkss.org/images/uploads/files/Riintegrimi_84989.pdf

35 Neni 54, par. 2, nënpar. 2.1 deri 2.8 të Ligjit Nr. 04\L -149 mbi Ekzekutimin e Sankcioneve Penale.

36 <https://shkk.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Rregullorja%20e%20brendshme%20per%20tretman.pdf>

i Viktimave vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme dhe e duhur për ta ndaluar shkeljen e të drejtave të viktimës dhe për të kërkuar veprim në garantimin e mbrojtjes së tyre.

ZMNV ofron informata ligjore për të drejtat e viktimave të krimit, ndihmë dhe përfaqësim në sistemin e drejtësisë. Me 7 zyra rajonale mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës.³⁷

Përfundimet dhe rekomandimet

Nga të dhënat e analizuara vijmë në përfundim që brenda periudhës janar-gusht 2022, në nivel vendi në Policinë e Kosovës janë raportuar 1 mijë e 852 raste të dhunës në familje, dhe referuar të dhënave zyrtare të pranuar nga ky institucion del se 581 raste apo rreth një e treta e total rasteve janë raportuar në rajonin e Prishtinës. Sa i përket të dyshuarve dhe të arrestuarve të personave që dyshohet se kanë ushtruar dhunë në familje shohim se pjesa më e madhe e tyre janë të gjinisë mashkullore dhe të moshës madhore. Ndërsa, sa i përket viktimave të dhunës në familje konstatojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të gjinisë femërore.

Lidhur me trajtimin e rasteve të kësaj natyre nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, vijmë në përfundim se ky institucion ka treguar efikasitet në trajtimin e dhunës në familje me kryes të mitur ndërsa kërkohet të rritet efikasiteti në trajtimin e rasteve të dhunës në familje kur kryesit e kësaj veprë penale janë madhorë.

Ndërsa, nga analizimi i 43 aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë (së bashku me degët), në periudhën janar – gusht 2022, shihet në vetëm në 5 raste kjo gjykatë ka shqiptuar dënim me burgim efektiv, ndërsa pjesa më e madhe e aktgjykimeve konsistojnë me dënime me kusht. Në anën tjetër e shohim se lidhur me këto raste, në 70% të tyre nuk është respektuar afati ligjor për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar nga momenti i ngritjes së aktakuzës. Gjithashtu, shohim se ka pasur raste kur kësaj gjykate nga ngritja e aktakuzës e deri në marrjen e vendimit për rastet e dhunës në familje iu janë dashur plotë 2 vjet e 7 muaj e 15 ditë, apo 958 ditë, ndërsa në disa raste kësaj gjykate iu janë dashur vetëm një ditë për ta gjykuar. Ndërsa mesatarja e gjykimit të këtyre rasteve është rreth tetë muaj.

Sa i përket gjendjes ekonomike dhe përgatitjes shkollore të të akuzuarve për dhunë në familje, nga të dhënat e analizuara rezultoi se në shumicën e rasteve të akuzuarit i përkasin gjendjes së dobët ekonomike ndërsa në bazë të komponentës së nivelit arsimor rezultoi se mbi 50% e të akuzuarve për dhunë në familje kanë të përfunduar shkollimin e mesëm.

Në anën tjetër, shihet zbrazëti juridike e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, ashtu që i njëjti nuk përmban dispozita të veçanta me të cilat specifikohen dhe përkufizohen veprimet inkriminuese të cilat e përbejnë dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe dhunës seksuale.

Së fundi, nevoja që rastet e dhunës në familje të trajtohen me prioritet të lart nga të gjitha institucionet duke filluar nga Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjykata, ZMNV, QPS dhe SHKK, por edhe organet e tjera që në çfarëdo forme mund të ndikojnë në uljen e dukurisë së dhunës në familje në vendin tonë. Këto institucione duhet të dëshmojnë se dhuna në familje nuk është me vetëm problem personal brenda një familje por që familja është institut që gëzon mbrojtje

37 Mandati i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), link: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Mbrojtja%20e%20viktimave/Zyra%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20dhe%20Ndihm%C3%AB%20Viktimave.pdf>

nga shteti i cili i sanksionon ata që ushtrojnë dhunë brenda marrëdhënies familjare dhe se viktimat trajtohen me kujdes duke ju siguruar mirëqenie dhe mbrojtje.

Nga të gjeturat e kësaj analize, "Just React" jep këto rekomandime:

1. Policia e Kosovës të trajtojë me seriozitet të lartë çdo rast të dhunës në familje, ashtu që në kohë sa më të shkurtër të identifikojë dhe arrestojë personat e dyshuar dhe për çdo veprim të jetë në koordinim me prokurorët e shtetit;
2. Policia e Kosovës të vazhdojë praktikën e mirë të informimit të publikut lidhur me rastet e dhunës të raportuara në çdo 24 orë në nivel vendi;
3. Prokuroria Themelore në Prishtinë ftohet që të rrisë efikasitetin në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje me të dyshuar që janë të moshës madhore dhe të vazhdojë trajtimin me efikasitet të këtyre lëndëve me kryes të mitur.
4. Gjykata Themelore në Prishtinë ftohet që të trajtojë me seriozitet më të lartë rastet e dhunës në familje në rastet kur të akuzuarit janë recidivist si dhe në aspektin e respektimit të afatit për caktimin dhe mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar;
5. Gjykata Themelore në Prishtinë ftohet që në aktgjykimet dënuese për veprën penale "Dhuna në familje", me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit të arsyetojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë të bëjnë me të akuzuarin;
6. Gjykata Themelore në Prishtinë ftohet që rastet e kësaj natyre t'i trajtojë me prioritet ashtu që rastet të gjykohen brenda një afati të arsyeshëm.
7. Ftohen institucionet si ZMNV, QPS dhe SHKK të rrisin kapacitetet dhe të trajtojnë me seriozitet çdo viktimmë ose kryes të dhunës në familje;
8. Rekomandohet plotësim/ndryshimi i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, me theks të veçantë sa i përket përkufizimeve të llojeve të dhunës në familje;
9. Rekomandohet që gjykatat të vazhdojnë edhe më tutje publikimin e aktgjykimeve në faqen zyrtare të tyre lidhur me rastet e dhunës në familje.

Raportimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje

JANAR – GUSHT 2022



Grupi për Studime
Juridike dhe
Politike

